VENDIM
Nr. 630, datë 10.10.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 466, DATË 10.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE PRIVATE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, NË TË CILAT ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4 e 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 466, datë 10.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas nënndarjes "iv", të shkronjës "b", të shtojcës nr. 1, përmendur në pikën 1, të kreut II, shtohet nënndarja "v", me këtë përmbajtje:

"v. Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të subjektit aplikues, drejtuesin/t e institucionit arsimor parauniversitar, personelin mësimor, administrativ dhe mbështetës.".

b) Shkronjat "c", "dh" dhe "gj", të shtojcës nr. 2, e përmendur në pikën 2, të kreut II, shfuqizohen.

c) Shkronja "d", e shtojcës nr. 2, e përmendur në pikën 2, të kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"d) Listën e plotë të personelit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ, si dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:

i. Për drejtuesin e institucionit arsimor ngarkohet certifikata e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar (shkollë/kopsht), e lëshuar nga Shkolla e Drejtorëve ose dokumenti që vërteton pranimin në trajnimin e detyrueshëm përgatitor, si dhe aktmarrëveshja për punësim në rastin e hapjes së institucionit.

Dëshmia e kualifikimit përkatës, ku të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" për drejtuesin e institucionit arsimor parauniversitar, ndërsa për drejtuesin e institucionit parashkollor ngarkohet diploma dhe libreza e punës me të paktën 5 (pesë) vite pune eksperiencë si mësues në arsimin parashkollor.

ii. Për personelin mësimdhënës ngarkohet licenca për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit, me përjashtim të mësuesit në arsimin parashkollor për të cilin ngarkohet diploma, si dhe aktmarrëveshja për punësim në rastin e hapjes së institucionit.

Për personelin mësimdhënës në arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë që përjashtohet nga detyrimi për dhënien e provimit të shtetit, ngarkohet diploma dhe libreza e punës që vërteton ushtrimin e profesionit përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për drejtuesin e institucionit arsimor ose personelin mësimdhënës, që ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të rregulluar të mësuesit jashtë Republikës së Shqipërisë, ngarkohet dokumenti provues, i lëshuar nga vendi ku është fituar kjo e drejtë, i njohur dhe njësuar nga institucionet përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktmarrëveshja për punësim në rastin e hapjes së institucionit".

iii. Për punonjësin administrativ, diploma e arsimit përkatës dhe aktmarrëveshja për punësim në rastin e hapjes së institucionit.

ç) Pas shkronjës "d", të shtojcës nr. 2, të përmendur në pikën 2, të kreut II, shtohet shkronja "d.1", me këtë përmbajtje:

"d.1) certifikatën e gjendjes gjyqësore për subjektin aplikues, drejtuesin/t e institucionit arsimor parauniversitar, personelin mësimor, administrativ dhe mbështetës.

Në rastin kur subjekti aplikues është person juridik, certifikatën e gjendjes gjyqësore edhe për administratorin, drejtorin ekzekutiv dhe anëtarët e organeve kolegjiale.".

d) Në fund të shtojcës nr. 2, të përmendur në pikën 2, të kreut II, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Kopja e lejes higjieno-sanitare dhe e aktit për mbrojtjen nga zjarri për godinën, ku do të ushtrohet veprimtaria e institucionit arsimor parauniversitar privat, të lëshuara nga institucionet përgjegjëse, sigurohen me ndërveprim nga strukturat përkatëse në ministrinë përgjegjëse për arsimin.".

dh) Në pikën 3, të kreut VI, fjalët "... duke ngarkuar dokumentacionin që përmban të dhënat dhe deklarimet, sipas shtojcës nr. 4 ..." zëvendësohen me "... duke plotësuar të gjitha të dhënat dhe deklarimet, sipas rubrikave të shtojcës nr. 4 ...".

e) Pas pikës 1, të kreut VII, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Procedurat e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik "e-Albania", zbatohen pasi ministria përgjegjëse për arsimin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e procesit të implementimit dhe datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit Parauniversitar, SMIP. Deri në fillimin e funksionimit të sistemit, aplikimet do të bëhen me kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet portalit qeveritar "e-Albania".

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit Parauniversitar, SMIP, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij vendimi, në kohën e paraqitjes së tyre.".

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku